



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 615 Prot.

Tiranë, më datë 19.04.2023

VENDIM
Nr. 212, datë 19.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimarrjes për projektin “Rindërtim i banesës ekzistuese 2 kat me çati”, banesa e znj. Amarilda Fejzo, rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative Nr. 4, Zona Arkeologjike “A”, Durrës, me aplikues Taulant Rama dhe zhvillues Amarilda Fejzo; Projekti të plotësohet me:
 - Rilevim me kuota të gjendjes aktuale të objektit;
 - Paraqitjen teknike në prerje të themeleve ekzistuese si dhe atyre të propozuara;
 - Të paraqitet i detajuar me prerje dhe kuota plansistemimi i objektit;
 - Të sqarohen zërat në preventiv për gërmime dhe transport dheu;
 - Të sqarohen gërmimet e parashikuara deri në kuotën 1.5m thellësi, në dokumentin e specifikimeve teknike;
 - Raporti i potencialit arkeologjik duhet të jetë në përputhje me dokumentacionin tekniko-ligjor të projektit.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

